

Data : 05.06.2024

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës – PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

I mbajtur sot më datë 05.06.2024, në Drejtorinë e Konvikteve të Shkollave të Mesme Tiranë, nga Njësia e Prokurimit, e përcaktuar në Urdhrin e prokurimit nr. 244, datë 03.06.2024, të titullarit të autoritetit kontraktor, në lidhje me argumentimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit, specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta për kualifikim, për procedurën e prokurimit me të dhënat e mëposhtme :

OBJEKTI I PROKURIMIT: “*Ndërtim shkalle emergjence, veshje fasade me kapotë, hidroizolim i tarracës dhe lyerje të brendshme me bojë hidroplastike*”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP) : (Punime ndërtimi).

- Shkalle 37441200-3
- Punë ndërtimi 45000000-7
- Punime strukturore prej çeliku 45223210-1
- Punime hidroizolimi 45261420-4
- Punime veshje 45262650-2
- Lyerje 45442100-8

VLERA E FONDIT LIMIT : 33.590.017 (tridhjetë e tre milion e pesëqind e nëntëdhjetë mijë e shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Argumentimi : Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës është referuar në preventivin e hartuar mbështetur në VKM Nr. 216, datë 13.4.2023 “*PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË INTEGRUAR PËR INFORMATIZIMIN E MANUALIT TË ÇMIMEVE PËR ZËRAT E PUNIMEVE NË NDËRTIM*”, si dhe testimi të tregut.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti kontraktor Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme (Njësia e Prokurimit), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë :

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMI

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 74, 82 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Nenet 14, 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr.2, datë 09.06.2021 “Miratimin e dokumentave standarte të tenderit për mallra, punë dhe shërbime për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, ndryshuar me Vendimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 10, datë 05.10.2022.

Ky kriter është i përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, i cili është vendosur duke u mbështetur në përcaktimet e nenit 82 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe ky formular është i publikuar në Shtojcën 8 të këtyre dokumentave të tenderit dhe duhet të plotësohet nga operatorët ekonomik pjesmarrës në të gjitha rubrikat e këtij formulari për të vërtetuar paraprakisht përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit të Shtojcës 7 të këtyre dokumentave të tenderit dhe për fuqinë punëtore, specialistët si dhe pajisjet dhe makineritë që disponon.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Nenin 30, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr.2, datë 09.06.2021 “Miratimin e dokumentave standarte të tenderit për mallra, punë dhe shërbime për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, ndryshuar me Vendimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 10, datë 05.10.2022.

Ky kriter është i përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, i cili është vendosur duke u mbështetur në përcaktimet e nenit 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 30, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe ky forma e paraqitjes së sigurimit të ofertës është i publikuar në Shtojcën 3 të këtyre dokumentave të tenderit dhe duhet të plotësohet nga operatorët ekonomikë pjesmarrës në të gjitha rubrikat e këtij formulari, ndërkohë që në Seksionin 3: **Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike**, Pika 3.1: Sigurimi i ofertës, të dokumentave të tenderit është përcaktuar periudha kohore e sigurimit të ofertës, vlera e sigurimit të ofertës dhe mënyra e paraqitjes së sigurimit të ofertës (ose nëpërmjet një kompanie sigurimi ose nëpërmjet garancisë bankare në numrin e llogarisë së institucionit tonë).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1. Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë licensë profesionale zbatimit, për subjektet juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e cila duhet minimalisht të ketë kategoritë dhe klasifikimet e mëposhtëme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- NP-1 A Punime gjurmimi në tokë.
- NP-3 A Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
- NP- 12 A Punime te inxhinierise se mjedisit

Për punimet special të ndërtimit :

- NS-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve

- **NS-4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
- **NS-8 A** Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri

Shënim: Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në Nr. 42, datë 16.01.2008). **Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.**

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtim”, të ndryshuar.

Në kërkesën që operatori ekonomik ofertues të disponojë një licensë për zbatimin e punimeve, autoriteti kontraktor është mbështetur në përcaktimet e bazës ligjore të sipërpërmendur dhe në faktin së objekti i prokurimit është punime civile dhe sipas legjislacionit për prokurimin publik dhe legjislacionit sekondar që të ushtrosh veprimtarinë ndërtimore në Republikën e Shqipërisë duhet që të jesh i pajisur me licensën përkatëse.

Lidhur me kategoritë e licensës dhe klasifikimin e tyre, autoriteti ynë kontraktor në përcaktimin e tyre është mbështetur në projekt-preventivat e hartuara dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtim”, të ndryshuar.

Autoriteti ynë kontraktor duke patur parasysh zërat e punimeve të përcaktuar në projektpreventivat e miratuar dhe vlerat përkatëse të këtyre zërave ka përcaktuar kategoritë e dhe klasifikimet e licensës si më poshtë vijon:

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.P - 1 A** “Punime gjërmimi në tokë”: *Konsiderohen gjërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.*

Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventiv me numer analize 2.5/a dhe 2.37/5b etj” , sipas parashikimit të VKM nr. 42 të sipërcituar, për këtë kategori dhe përcaktimi i nivelit “A” të kësaj kategorie është bërë në bazë të vlerës së gjithë zërave të projekt-preventivit që përfshihen në këtë kategori punime dhe ku vlera e tyre është më e vogël se 21 milion dhe referuar Lidhjes 4, të po kësaj VKM-je, sipas të cilës, për punime në vlerën 0 deri 21 milion lekë, nevojitet klasifikimi niveli “A”.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.P - 3 A** “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash”: *Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.*

Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventiv, sipas parashikimit të VKM nr. 42 të sipërcituar, për këtë kategori dhe përcaktimi i nivelit “A” të kësaj kategorie është bërë në bazë të vlerës së gjithë zërave të projekt-preventivit që përfshihen në këtë kategori punime dhe ku vlera e tyre është më e vogël se 21 milion dhe referuar Lidhjes 4, të po kësaj VKM-je, sipas të cilës, për punime në vlerën 0 deri 21 milion lekë, nevojitet klasifikimi niveli “A”.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S –1 A** “Punime për prishjen e ndërtimeve”: *Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksploziv me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.*

Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventiv me numer analize 2.426 , 2.426/5 dhe 2.303, konkretisht zërat (Prishje mur tulle pa pastrim, Prishje struktura betoni ,Heqje dritare d/alumini ne fasade ,Prishje suvatim mure tulle fasade etj)” , sipas parashikimit të VKM nr. 42 të sipërcituar, për këtë kategori dhe përcaktimi i nivelit “A” të kësaj kategorie është bërë në bazë të vlerës së gjithë zërave të projekt-preventivit që përfshihen në këtë kategori punime dhe ku vlera e tyre është më e vogël se 21 milion dhe referuar Lidhjes 4, të po kësaj VKM-je, sipas të cilës, për punime në vlerën 0 deri 21 milion lekë, nevojitet klasifikimi niveli “A”.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S - 4 A** “Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese”: *Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.*

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashme, të veshjeve të brendshme dhe të jashme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventiv dhe konkretisht zërave të punimeve “Punime suvatimi dhe veshje” , sipas parashikimit të VKM nr. 42 të sipërcituar, për këtë kategori dhe përcaktimi i nivelit “A” të kësaj kategorie është bërë në bazë të vlerës së gjithë zërave të projekt-preventivit që përfshihen në këtë kategori punime dhe ku vlera e tyre është më e vogël se 21 milion dhe referuar Lidhjes 4, të po kësaj VKM-je, sipas të cilës, për punime në vlerën 0 deri 21 milion lekë, nevojitet klasifikimi niveli “A”.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S - 8 A** “Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri”: *Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur. Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër. Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara.*

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventivin “Punime Konstruksioni”, konkretisht këtu përfshihen zërat me emërtesë “Konstruksione metalike te perbera etj”.

Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventiv dhe konkretisht zërave të punimeve “Konstruksione metalike te perbera etj sipas parashikimit të VKM nr. 42 të sipërcituar, për këtë kategori dhe përcaktimi i nivelit “A” të kësaj kategorie është bërë në bazë të vlerës së gjithë zërave të projekt-preventivit

që përfshihen në këtë kategori punime dhe ku vlera e tyre është më e vogël se 21 milion dhe referuar Lidhjes 4, të po kësaj VKM-je, sipas të cilës, për punime në vlerën 0 deri 21 milion lekë, nevojitet klasifikimi niveli “A”.

Lidhur me ofertuesit që mund të marrin pjesë dhe të dorëzojnë ofertë në këtë procedurë prokurimi dhe që janë shoqëri të huaja, autoriteti ynë kontraktor ka përcaktuar se duhet që këta operatorë ekonomikë duhet që të kenë licensë të lëshuar sipas përcaktimeve të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtim”, të ndryshuar, pasi referuar pikës 1 “Qëllimi dhe fusha e veprimit” të kësaj VKM-je është përcaktuar se: “*Licencimi, sipas kësaj rregulloreje, është i detyrueshëm për çdo subjekt juridik vendas ose të huaj, që ushtron veprimtari ndërtimore zbatuese në Republikën e Shqipërisë pavarësisht formës së organizimit të tij.*”, prandaj autoriteti ynë kontraktor ka përcaktuar se këta operatorë ekonomik duhet që të kenë dhe të paraqesin ekuivalentim të licensës.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar :

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, 2023** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 33.590.000 leke..**

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3 e të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 291, datë 15.5.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”.*

Autoriteti ynë kontraktor ka gjykuar si të nevojshëm vendosjen e këtij kriteri kualifikues, pasi na jep siguri se operatori ekonomik ofertues ka kapacitete financiare për kryerjen e punimeve objekt-prokurimi, si dhe është mbështetur në përcaktimet e Nenin 77, pika 3 e të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar

Në përcaktimi i vlerës dhe periudhës së vlerës së xhiros së kërkuar, autoriteti kontraktor është mbështetur në vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi e cila është në vlerën 33.590.017 leke pa-TVSH dhe referuar Kreut II “KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK” të VKM Nr. 291, datë 15.5.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik” kjo procedurë prokurimi është ndërmjet kufirit të lartë monetarë dhe kufirit të ulët monetarë dhe referuar Nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar është përcaktuar që operatori ekonomik ofertues të ketë një xhiro vjetore prej jo më pak se vlera e fondit limit, ndërkohë që referuar përcaktimeve të Nenin 43, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar është përcaktuar që operatorët ekonomik ofertues që të kualifikohen duhet që të kenë realizuar minimalish këtë xhiro në njërin nga 3 (tre) vitet e fundit të aktivitetit dhe konkretisht vitet 2021, 2022 dhe 2023.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku bilancet e dy viteve nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit..

Shënim: Nëse bilancet e kërkuara më sipër janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika “c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, duhet të paraqesë përveç bilancit edhe raportin e ekspertit kontabël të regjistruar (miratuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 3, Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe Nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar dhe Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar Nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar dhe Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në Nenin 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore" "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji".

Ndërsa kërkesa për paraqitjen e raportit të ekspertit kontabël të regjistruar (miratuar) është hartuar duke u mbështetur në përcaktimet e nenit 41, pika "c" të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar dhe vetëm për ato operatorë ekonomikë ofertues të cilëve bilancet e tyre të viteve 201, 2022 dhe 2023 plotësojnë kushtet kumulative të këtij neni për tu pasijur me raport nga eksperti kontabël i miratuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se **16,795,000 leke pa-TVSH** dhe që është realizuar **gjatë pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë vjetëve të fundit, është jo më e vogël se 33,590,000 leke pa-TVSH.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Në rastin kur ofertuesi është bashkim operatorësh ekonomikë, kërkesa e përcaktuar në pikën 2.3.1/a të këtij kriteri kualifikues plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për plotësimin e këtij kriteri kualifikues operatorët ekonomik ofertues duhet që të paraqesin dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular Vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;

- Faturat tatimore,
- Aktin e kolaudimit;

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore;
- Akt kolaudimi objekti;

Shënim: *Vërtetimi duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

Shënim: Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit;

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, deklaratën e dorëzuar nga ofertuesi lidhur me punimet që do të kryejë nënkontraktori, si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77 pika 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe Nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.*

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi dhe kjo kërkesë është bazuar në përcaktimet e Nenit 77 pika 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ndërsa vlera minimale e përvojës së mëparshme është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën **16,795,000 leke pa-TVSH**, për një objekt të vetëm, ose minimalisht në vlerën 33,590,000 leke pa-TVSH, për disa punime të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, ku këto vlera janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar Nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.*

Dokumentacioni provues (në rastin e punimeve të ngjashme të realizuara me ente publike) është përcaktuar duke u mbështetur në legjislacionin e prokurimit publik dhe legjislacionin për ndërtimin, pasi çdo procedurë prokurimi finalizohet me një kontratë të lidhur midis entit kontraktor dhe operatorit ekonomik ofertues të shpallur fitues, si dhe gjatë zbatimit të kontratës në bazë të legjislacionit për ndërtimin kontraktori dorëzon situacionet pjesore (sipas grafikut të zbatimit të punimeve) të shoqëruar me faturën tatimore përkatëse, situacionin përfundimtar dhe përpara marrjes në dorëzim të punimeve nga ana e entit kontraktor (investitorit) përpilohet akti i marrjes në dorëzim të punimeve ku firmosin kolaudatori, supervizori i punimeve dhe zbatuesi i punimeve sipas legjislacionit për ndërtimin në epublikën e Shqipërisë.

Gjithashtu pjesë e dokumentave standarte të tenderit të miratuara me Vendimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr.2, datë 09.06.2021 “Miratimin e dokumentave standarte të tenderit për mallra, punë dhe shërbime për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, ndryshuar me Vendimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 10, datë 05.10.2020 është edhe Shtojca 9 “Formulari i vlerësimit” i cili është i detyrueshëm për tu paraqitur nga ana e operatorëve ekonomikë për kontrata të realizuara me ente publike.

Dokumentacioni provues (në rastin e punimeve të ngjashme të realizuara me subjekte private) është përcaktuar duke u mbështetur në legjislacionin për urbanistikën dhe legjislacionin për ndërtimin, pasi çdo investim privat duhet që të pajiset me leje ndërtimi dhe për tu pajisur me këtë leje duhet një kontratë midis investitorit dhe zbatuesit të punimeve, si dhe gjatë zbatimit të kontratës në bazë të legjislacionit për ndërtimin kontraktori dorëzon situacionet pjesore (sipas grafikut të zbatimit të punimeve) të shoqëruar me faturën tatimore përkatëse, situacionin përfundimtar dhe përpara marrjes në dorëzim të punimeve nga ana e entit kontraktor (investitorit) përpilohet akti i marrjes në dorëzim të punimeve ku firmosin kolaudatori, supervizori i punimeve dhe zbatuesi i punimeve sipas legjislacionit për ndërtimin në epublikën e Shqipërisë.

Dokumentacioni provues është shumë i rëndësishëm për të vlerësuar ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ofertues, pasi jep informacion të hollësishëm lidhur me vlerësimin e autoritetit kontraktor nëse punimet e kryera nga ofertuesi janë ose jo të ngjashme me zërat e punimeve të preventivit objekt-prokurimi, jep informacion të hollësishëm lidhur me vlerën e këtyre punimeve të ngjashme dhe afatin e kryerjes së tyre.

Në nenin 14 pika 2 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe Nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar është përcaktuar se oferta mund të paraqitet dhe nga një bashkim operatorësh ekonomikë dhe në këtë rast për kontrata të realizuara midis një bashkim operatorësh ekonomikë dhe një enti kontraktor, operatorët ekonomikë pjesëmarrës përveç dokumentacionit të sipërpërmendur duhet që të paraqesin dhe kontratën e bashkëpunimit të lidhur midis tyre për kontratën që kanë realizuar (ku kjo kontratë bashkëpunimi është dorëzuar në fazën e ofertimit) me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë se cilat zëra punimesht të përcaktuara në situacionin përfundimtar ka realizuar secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomike dhe nëse këton zëra punimesh janë ose jo të ngjashme me zërat e punimeve objekt-prokurimi.

Në nenin 126 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe Nenit 89 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjvënësi ka lejuar që operatorët ekonomikë ofertues mund të përcaktojnë që në fazën e ofertimit nënkontraktorin e disa prej punimeve objekt-prokurimi në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së kontratës që prokurohet dhe në rast se shpallen fitues me miratimin e titullarit të autoritetit kontraktor lidhin kontratë për kryerjen e këtyre punime, prandaj në këtë rast autoriteti ynë kontraktor ka përcaktuar se për këto kontrata ofertuesi duhet të paraqesë aktin e miratimit të titullarit të autoritetit kontraktor dhe deklaratën për nënkontraktorin, pasi me këto dokumenta gjykon mbi vlefshmërinë e kontratës dhe zërat e punimeve të realizuara nga nënkontraktori.

2.3.2. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me license leshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (Për grumbullim, ruajtje dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

Argumentimi : *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39 pika 6 gërma b) dhe pika 7 gërma c) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (të ndryshuar), si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”.*

Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën **për transportin e mbetjeve**, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve objekt prokurimi ku disa punime janë punime prishje dhe prodhohen mbetje inerte të cilat në bazë të legjislacionit mjedisor janë të detyrueshme për tu evaduar në landfill, me qëllim ruajtjen e mjedisit.

Ky kriter synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta, nëpërmjet administrimit mjedisor të tyre në çdo fazë, përfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin, të cilat çojnë në pakësimin e mbetjeve dhe zvogëlimin e ndikimeve të tyre të rrezikshme e të dëmshme. Duke qënë se në preventivin e punimeve janë pasqyruar punime prishje është gjykuar se subjekti duhet të ketë lejen e posaçme për veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme ndërtimore. Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit ku parashikohen transportim materiale inertesh dhe dhera për shkak të gërmimeve dhe prishjeve. (Seksioni I-rë i preventivit “Punime prishje”).

2.3.3 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik :

a) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë :

- Inxhinier Ndërtimi 2 (dy)
- Arkitekt 1 (një)

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3/a operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë pune, Diplomën Universitare, Libreze pune dhe Cv për drejtuesit teknike të kërkuar.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit E-sig 025/a që kërkohet nga legjislacioni tatimor në fuqi për muajt Shkurt 2024, Mars 2024 dhe Prill 2024, ku të figurojnë drejtuesit teknik të kërkuar.

Shënim: Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri deh në rast të mos përmbushjes kjo do të përbëjë shkak për skualifikimi..

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesat e shkronjës a) të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, *Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm inxhinierik referuar zërave të preventivit të objektit për realizimin e kontratës në mbështetje të pikës 4 të Nenit 77 të Ligjit 162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe në mbështetje të Nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar pika 6, germa (c) ku specifikisht përcaktohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: :..... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...”* Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, CV apo qënësia e tyre në listpagesat e shoqërisë, janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se këta drejtues teknikë janë **operativë** pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtimit dhe arkitektit është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Kërkesa për inxhinierët e ndërtimit është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit të prokurimit. Është kërkuar që operatori ekonomik ofertues të ketë drejtues teknik 2 (dy) inxhinier ndërtimi për zbatimin e punimeve në përputhje me zërat e pasqyruara në preventivit, termave të referencës dhe specifikimeve teknike që do të zbatohen dhe si dhe kategorive përkatëse në licencën përkatëse të zbatimit. Inxhinieri i ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të preventivit për secilin nga zërat e punimeve dhe për cilësinë e materialeve që vendosen në objektet ku do të kryhen punimet. Kërkesa për 2 inxhinieri ndërtimi në objekt janë kërkuar për faktin se janë 3 objekte në vende të ndryshme në qytetin e Tiranës dhe 1 inxhinier nuk mund të ndjekë njëkohësisht të 3 objektet, pasi punimet në këto objekt do të kryhen njëkohësisht, pasi duhet të jenë gati për fillimin e vitit të ri shkollor. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit. Është kërkuar inxhinier ndërtimi për zbatimin e shërbimeve në përputhje me zërat e pasqyruara në preventivit, termave të referencës dhe specifikimeve teknike që do të zbatohen dhe si dhe kategorive përkatëse në licencën përkatëse të zbatimit. Inxhinieri i ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të preventivit për secilin nga zërat e shërbimeve dhe për cilësinë e materialeve që vendosen në objektet ku do të kryhen shërbimet.

b) Kërkesa për 1 (një) arkitekt inxhinierin elektrik është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit të prokurimit. Është kërkuar arkitekti është përcaktuar nisur nga nevoja për të realizuar arkitekturën e punimeve sipas projektit të miratuar dhe të publikuar në këto dokumenta tenderit, ku pjesë e rëndësishme janë përcaktimi dhe zbatimi i hollësive në fasadë dhe veshja me gur dekorativ sipas projektit të miratuar, si dhe përcaktimi i ngjyrës së bojës me të cilën do të lyhet fasada..

b) Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë :

- Teknik Ndërtimi	1 (një)
- Hekurkthyes	1 (një)
- Muratore	1 (një)
- Suvatues	2 (dy)
- Hidroizolues	2 (dy)
- Saldator	2 (dy)
- Përgatitës të konstruksioneve metalike dhe të ngjashëm	3 (tre)
- Termoizolues	5 (pesë)
- Specialist për sisteme të thata në ndërtesa	7 (shtate)
- Bojaxhi	5 (pesë)
- Punonjës për veshje fasade (sistemi kapot)	20 (njëzet)
- Punonjës duro-alumini	1 (një)

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3/b operatori ekonomik duhet të paraqesë::

- kontratën individuale të punës per secilin prej punonjësve të specializuar/të kualifikuar;
- një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/ diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar, pwr secilin prej punonjësve të specializuar/të kualifikuar.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit E-sig 025/a që kërkohet nga legjislacioni tatimor në fuqi për muajt Shkurt 2024, Mars 2024 dhe Prill 2024, ku te figurojnë secili prej punonjësve të specializuar/të kualifikuar te kerkuar.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesat e shkronjës b), të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. *Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyrës së punimeve që kërkohen të prokurohen siç janë punimet për mirëmbajtjen e objekteve rezidenciale arsimore është e nevojshme pasja e një stafi teknik të kualifikuar, për realizimin me sukses të kontratës. Punonjësit e kualifikuar janë kërkuar duke u bazuar në natyrën e zerave të punimeve të parashikuara për t’u kryer në preventivin e publikuar dhe volumin e punimeve që kërkohen. Me qëllim garantimin e realizimit të kontratës, stafi teknik inxhinierik dhe punonjësit e kualifikuar të kërkuar nga autoriteti kontraktor duhet të figurojnë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues.*

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të natyrës së punimeve të përcaktuara në preventiv dhe të grafikut të punimeve.

- **Tekniku i ndërtimit** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve, pasi ka formimin profesional të duhur për organizimin e punimeve ndërtimore, kujdeset për mbarëvajtjen e kantierit dhe delegon detyrat e lëna nga inxhinieri i ndërtimit tek specialistët dhe punëtorët për realizimin e punimeve sipas preventivit dhe projektit.
- **Hekurkthyesi** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të hekurit, referuar zërave të preventivit të punimeve, pasi ka formimin e duhur profesionale për realizimin e zërit të preventivit "Punime betoni dhe B'A" dhe që jep siguri autoritetit kontraktor lidhur me kryerjen me cilësi dhe në kohë të këtyre punimeve.
